



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 4 Prot.

Tiranë, më 22/05/2024

V E N D I M

Nr. 4, datë 22/05/2024

PËR

SHPLLJEN E AFATEVE PËR FILLIMIN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR REKTOR DHE ANËTARË TË SENATIT AKADEMIK, DHE MIRATIMIN E FORMATIT TË DOKUMENTACIONIT PËR KANDIDIM

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 6, neni 18, si dhe vendimin nr. 1, datë 20/05/2024 të KIZ” Për konstituimin e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe zgjedhjen e kryetarit të tij”, në mbledhjen e datës 22.05.2024 Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Të shpallë afatin për fillimin e procesit të regjistrimit të kandidatëve për rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik.
 - 1.1 Afati i aplikimit për rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik fillon në datën 23.05.2024 dhe përfundon në datë 27.05.2024 ora 16:00. Dorëzimi i dokumentacionit kryhet nga ora 10:00–16:00 pranë Sekretarisë së KIZ (Kati i 3-të i godinës së Korpusit Qendror të UPT).
2. Të miratojë dokumentacionin përkatës për kandidim për rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik, sipas formateve bashkëlidhur këtij vendimi.
 - 2.1 Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të dorëzojnë në Sekretarinë e KIZ kandidatët për rektor dhe anëtarë të Senatit Akademik është:
 - Kërkesa për kandidim (formulari i kandidimit për personel akademik);
 - Vetëdeklarimi për mungesën e plagjiaturës (Formulari për mungesën e plagjiaturës);









- Vetëdeklarimi që kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit 9741, datë 21.05.2017, nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale, si dhe nuk është objekt i ligjit 138/2015 dhe ligjit 45/2015.
- Kopje e dokumentetit të identifikimit;
- Kopje e gradës/titullit. Për kandidatët që vijnë jashtë UPT-së, kopja e gradës/titullit kërkohet e noterizuar;
- Dokumenti që vërteton vendin ku është i punësuar kandidati;
- Vërtetim nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike që ndaj kandidatit nuk është dhënë masë disiplinore.

2.2 Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga studentët kandidatë për anëtarë të Senatit Akademik është:

- Kërkesë për kandidim (formulari i kandidimit për studentë);
- Kopje e dokumentit të identifikimit;
- Vërtetimi që është student me kohë të plotë në fakultetin përkatës në UPT;
- Dokumentin që vërteton se është student i ekselencës ose me notë mesatare të ponderuar deri në momentin e kandidimit mbi 8 (lista e notave të jetë e 30 ditëve të fundit dhe nota mesatare të jetë e përllogaritur nga sekretaria mësimore);
- Propozimin nga jo më pak se 30 studentë pjesë e trupës zgjedhore. Mbështetja për kandidatin shprehet përmes plotësimit të formularit të mbështetjes së kandidatit sipas modelit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Edmond PERGEGA	Kryetar 
Alfred PJETRI	Anëtar 
Albina BASHOLLI	Anëtar 
Anjeza DULAJ (GJINI)	Anëtar 
Nelda KOTE	Anëtar 
Irida GJOKA (MARKJA)	Anëtar 
Klajdi QOSHI	Anëtar 
Pietro BELBA	Anëtar 
Lidia HYSA	Anëtar 